



30 MARS 2020

Masat e marra në kuadër të Pandemisë COVID-19 nga Autoritetet Shqiptare

Për shkak të përhapjes së virusit COVID-19 Autoritetet Shqiptare kanë marrë një sërë masash për të parandaluar përhapjen e tij. Më poshtë janë të listuar të gjitha masat e ndërmarra deri më datë 30 Mars 2020.

Përmbajtja

ORARET E LËVIZJES DHE ZHVILLIMIT TË AKTIVITETEVE.....	1
Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 249, datë 27.03.2020 “Për detajimin dhe përdorimin e fondit antiCovid-19”.....	2
Akti Normativ Nr. 11, datë 27.03.2020 “Për sistemin e Taksave Vendore, të ndryshuar”.....	3
Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 254, datë 27.03.2020 “Për Përcaktimin e Procedurave, të Dokumentacionit dhe të Masës së Përfitimit të Ndhmës Financiare për të Punësuarit në Subjektet e Biznesit me të Ardhura Vjetore deri 14 Milionë lekë, Ndhmës Ekonomike e të Pagesës të së Ardhurës nga Papunësia gjatë Periudhës së Fatkeqësisë Natyrore, të shpallur si pasojë e Covid-19”.....	3
Udhëzues praktik për mënyrën e aplikimit për Përfitim të ndihmës financiare, sipas VKM nr.254 datë 27.03.2020	5

ORARET E LËVIZJES DHE ZHVILLIMIT TË AKTIVITETEVE

Autoritetet Shqiptare kanë njoftuar se do të ndryshojë orari i lejuar për lëvizjen e individëve si dhe orari i aktivitetit të subjekteve (pikat e shitjes së ushqimeve, farmacitë, shërbimet bankare, administrata shtetërore). Duke nisur nga e Hëna, datë 30 Mars 2020 individët mund të lëvizin brenda orarit të lejuar 05:00 – 13:00, pasi të jenë pajisur me leje dalje e cila është e vlefshme për një orë.

Aplikimi për leje daljen mund të bëhet nëpërmjet portalit e-albania ose duke dërguar një mesazh në Nr. e telefonit 55155 (Nr. Personal, orari i lëvizjes) për të gjithë shtetasit shqiptar. Shtetasit e huaj mund të aplikojnë për leje dalje duke dërguar një mesazh në Nr. e telefonit 55155 (F, Nr. Pasaportës, orari i lëvizjes)

Do të lejohet lëvizja e mjeteve (autobusë, furgona, etj.) për transportin e personelit të bizneseve me aktivitet të lejuar sipas orareve të përcaktuar. Këto biznese duhet të pajisen me autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Për aplikimin për autorizim duhet të përgatiten dhe dorëzohen dokumentet e mëposhtme:



- Kërkesë nga subjekti
- Të dhënat e mjeteve të transportit që do të përdoren
- Të dhënat e personelit

Nëse subjekti nuk garanton transportin e personelit, individët mund të përdorin automjetin privat pasi të dorëzojnë formularin e vetë deklarimit, i cili mund të gjendet në link-un e mëposhtëm:

["Covid-19" - Lëvizja e kontrolluar me mjet!](#)

Deklarimet e pasakta e ngarkojnë individin me përgjegjësi penale dhe administrative.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 249, datë 27.03.2020 “Për detajimin dhe përdorimin e fondit antiCovid-19”.

Mund të shkarkoni dokumentin në link-un e mëposhtëm:

[Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 249, datë 27.03.2020 “Për detajimin dhe përdorimin e fondit antiCovid-19”](#)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave vendosi:

1. Fondi antiCovid-19, prej 2,500 miliard lekësh, përdoret nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas detajimeve të mëposhtme:

- a) Në masën 500 milionë lekë, në programin “Shërbimet e kujdesit dytësor”, në kategorinë e shpenzimeve korrente;
- b) Në masën 150 milionë lekë, në programin “Shërbimet e shëndetit publik”, në kategorinë e shpenzimeve korrente;
- c) Në masën 50 milionë lekë, në programin “Shërbimi Kombëtar i Urgjencës”, në kategorinë e shpenzimeve korrente;
- d) Në masën 800 milionë lekë, në programin “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”, në kategorinë e shpenzimeve korrente;



- e) Në masën 1 000 milionë lekë, në programin “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”, në kategorinë e shpenzimeve kapitale.
2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Akti Normativ Nr. 11, datë 27.03.2020 “Për sistemin e Taksave Vendore, të ndryshuar”.

Mund të shkarkoni dokumentin në link-un e mëposhtëm:

[*Akti Normativ Nr. 11, datë 27.03.2020 “Për sistemin e Taksave Vendore, të ndryshuar”.*](#)

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, ky Akt Normativ parashikon zgjatjen e afatit për parapagimin e kësteve të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për tatimpaguesit subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e me qarkullim nga 5 deri në 8 milionë lekë.

Pagesat e kësteve të parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin kryhen pranë bankave të nivelit të dytë dhe Postës Shqiptare, sh.a., për llogari të administratës tatimore, për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2020 brenda datës 20 Tetor 2020, ndërsa për tremujorin e tretë dhe të katërt të vitit 2020 brenda datës 20 Dhjetor 2020

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 254, datë 27.03.2020 “Për Përcaktimin e Procedurave, të Dokumentacionit dhe të Masës së Përfitimit të Ndhmës Financiare për të Punësuarit në Subjektet e Biznesit me të Ardhura Vjetore deri 14 Milionë lekë, Ndhmës Ekonomike e të Pagesës të së Ardhurës nga Papunësia gjatë Periudhës së Fatkeqësisë Natyrore, të shpallur si pasojë e Covid-19”.

Mund të shkarkoni dokumentin në link-un e mëposhtëm:

[*Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 254, datë 27.03.2020 Për Përcaktimin e Procedurave, të Dokumentacionit dhe të Masës së Përfitimit të Ndhmës Financiare për të Punësuarit në Subjektet e Biznesit me të Ardhura Vjetore deri 14 Milionë lekë, Ndhmës Ekonomike e të Pagesës të së Ardhurës nga Papunësia gjatë Periudhës së Fatkeqësisë Natyrore, të shpallur si pasojë e Covid-19*](#)



Në bazë të VKM nr.254 datë 27.03.2020 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore të shpallur si pasojë e COVID-19”, subjektet tatimpagues të cilët do të aplikojnë për përfitim të ndihmës financiare, duhet që:

- a) për vitin 2019 të kenë realizuar të ardhura deri në 14 milionë lekë,
- b) të kenë ndërprerë aktivitetin në zbatim të Urdhrave të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), të dala për këtë qëllim, si dhe
- c) duhet të kenë përgjegjësi tatimore për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin ose tatimin mbi fitimin

Për të dorëzuar formularin “Kërkesë për përfitim të ndihmës financiare”, çdo tatimpagues që plotëson kriteret e mësipërme, duhet të aplikojë nëpërmjet llogarisë së deklarimit elektronik, në e-filing, duke filluar nga data 1 Prill e në vijim.

Udhëzuesi praktik mbi mënyrën e aplikimit dhe plotësimit të këtij Formulari (bashkëngjitur këtij njoftimi) shpjegon hapat që duhet të ndiqen për plotësimin në mënyrë korrekte të tij.

Individët, me status i vetëpunësuar, përfitues sipas VKM-së Nr.254, date 27. 03.2020, në plotësimin e Formularit për përfitimin e ndihmës financiare, nëse nuk disponojnë një llogari personale, mund të përdorin të dhënat e llogarisë bankare të hapur për qëllim të biznesit. Nëse nuk e disponojnë një llogari biznesi, do të duhet të paraqiten pranë një prej bankave të niveli të dytë, për të bërë të mundur hapjen e një llogarie bankare personale apo biznesi.

Individët përfitues (punonjësit e papaguar të familjes të personit fizik tregtar; të punësuarit në personat fizikë tregtarë; të punësuarit në personat juridikë), të cilët nuk disponojnë një llogari bankare aktive, duhet të paraqiten pranë një prej bankave të nivelit të dytë që operojnë në vendin tonë, për të bërë të mundur hapjen e një llogarie bankare.

Kujdes: Të dhënat e llogarisë bankare, bëjnë pjesë në të dhënat e detyrueshme për t’u plotësuar në Formularin e përfitimit të ndihmës financiare

Ato duhet të disponohen nga individët përfitues dhe duhet t’i vihen në dispozicion subjektit, përpara kryerjes së aplikimit elektronikisht në llogarinë e deklarimit elektronik.



Subjektet me status i vetëpunësuar, të cilët mund të jenë nën masa të mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore (bllokim llogarie bankare), duhet të hapin një llogari personale bankare, (e cila nuk mund të përdoret për qëllime të tjera), për të bërë të mundur përfitimin e ndihmës financiare.

Subjektet që do të plotësojnë kërkesën, duhet të sigurohen që të plotësojnë të dhënat e sakta të individëve përfitues, ku IBAN i llogarisë bankare është e dhënë shumë e rëndësishme.

Plotësimi i pasaktë i kësaj të dhëne, bllokon procesin e kalimit të pagesës nga Thesari, edhe për përfituesit e tjerë, pjesë e të njëjtit Formular.

Udhëzues praktik për mënyrën e aplikimit për Përfitim të ndihmës financiare, sipas VKM nr.254 datë 27.03.2020

Aplikimi kryhet nga subjektet të cilët plotësojnë kushtet sipas VKM 254 datë 27.03.2020, të cilët janë:

- për vitin 2019 të kenë realizuar të ardhura deri në 14 milionë lekë,
- të kenë ndërprerë aktivitetin në zbatim të Urdhrave të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), të dala për këtë qëllim, si dhe
- duhet të kenë përgjegjësi tatimore për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin ose tatimin mbi fitimin

Ju njohim me hapat që duhet të ndiqni për plotësimin e Formularit për përfitim të ndihmës financiare:

1. Logohuni në llogarinë tuaj të deklarimit elektronik e-filing, duke vendosur Emrin e përdoruesit dhe Fjalëkalimin

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE **E-Tax Shqipëri**


Mirëseerdhët
Nëse tashmë jeni i regjistruar në e-filing mund të hyni në sistem. Në të kundërt duhet të regjistroheni që të hyni në sistem.

Regjistro
Jeni një individ privat dhe doni të dorëzoni Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave Për Individët?
Ju lutemi, për një regjistrim të ri ose për hyrje për herë të parë në sistem [Regjistrohuni këtu](#)

Nëse nuk jeni nënshetetas Shqiptar, duhet të drejtoheni në zyrën më të afërt tatimore për tu regjistruar!


Hyr në sistem
Emri i Përdoruesit:
Fjalëkalimi:
Gjuha: Shqip (sq-AL) ▼
 E lexova dhe bie dakord me [termat dhe kushtet](#)

2. Pozicionohuni në menunë e-filing Im, dhe zgjidhni nën-menu Çështjet e mia




The screenshot shows the top navigation bar of the system with tabs: Deklarata, Listëpagesat, Librat e Shitjeve dhe Blerjeve, Kontabilitet, eFiling Im, Menaxhimi i Aksesit, and Rreth eFiling. The 'eFiling Im' tab is selected, and a dropdown menu is open showing options: Dokumentat e Mia, Njoftimet e Mia, Çështjet e Mia (highlighted), and Profili Im. Below the menu, the text 'Mirëseerdhët në e-Filing' is displayed, followed by a section titled 'Versionet e kërkuesve të internetit:' with a list of browser versions: Internet Explorer nga versioni 10, Mozilla Firefox nga versioni 25, and Google Chrome nga versioni 30. A note below states: 'Kujdes: Kur përdorni Internet Explorer-in sigurohuni që pamja e përshatjes është fikur.'

3. Zgjidhni rubrikën Krijo Çështje dhe klikoni mbi të:




The screenshot shows the 'E TATIMEVE' section of the system. The navigation bar includes tabs: Deklarata, Listëpagesat, Librat e Shitjeve dhe Blerjeve, Kontabilitet, eFiling Im, Menaxhimi i Aksesit, and Rreth eFiling. The 'eFiling Im' tab is selected. On the left, there is a sidebar with 'Te Gjitha Çështjet' and sub-items: Të Padorezuara (0), Çështje në Proces, and Çështje të Mbyllura. The main area is titled 'Çështje të Padërguara' and contains a search form with a dropdown for 'Lloji i Çështjes' (set to '???'), a 'Kërko' button, and a 'Pastro Filtrat' button. Below the search form is a table with columns 'Numri i Dokumentit' and 'Data e krijimit'. A message below the table states: 'Nuk ka të dhëna të disponueshme në tabelë' and 'E para E Mëparshme Pasues E Fundit'. At the bottom, there are buttons for 'Krijo Çështje' and 'Fshi Çështjen'.

4. Në dritaren që do t'ju shfaqet në ekran zgjidhni Kërkesë për përfitim në ndihmës financiare




The screenshot shows a dialog box titled 'Krijo një Çështje të Re'. It has a dropdown menu for 'Lloji i Çështjes *' with the value '???' selected. The dropdown list is open, showing options: '???' (selected), 'Certificate, Çertifikatë', 'GeneralQuestion, Pyetje e Përgjithshme', and 'KËRKESËNDIHMËFINANCIARE, Kerkese për përfitim të ndihmës financiare'. A 'Krijo' button is located at the bottom left of the dialog box.

5. Plotësoni periudhën për të cilën po aplikoni, në kutizën Periudha (duke filluar nga Prill 2020, e cila i referohet deklarimit për muajin mars, sipas Urdhrave të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale)



6. Pas këtij hapi, ju shfaqet mesazhi që konfirmon se Çështja është krijuar me sukses:



7. Në këtë moment duke klikuar në butonin Shfaq për ndryshim, ju mund të filloni me plotësimin e formularit:




8. Formulari që do t'ju shfaqet në ekran do të ketë të para plotësuar, të dhënat e përgjithshme të subjektit tuaj, emrat dhe ID e punonjësve që potencialisht do të jenë përfitues të ndihmës

financiare, dhe ju duhet të plotësoni saktë, si të dhëna të detyrueshme për t'u plotësuar në bazë të VKM nr.254, datë 27.03.2020 :

- Nr. Telefoni subjekti,
- email subjekti,
- IBAN të secilit individ përfitues
- Nr. Telefonit dhe adresën email të secilit individ përfitues

Emrin e bankës, për secilin individ përfitues, ju mund ta zgjidhni nga lista që ju shfaqet duke klikuar mbi kutizën Banka



9. Është shumë i rëndësishëm plotësimi i rubrikës së mëposhtme:

Deklarimi dhe pagesa e sigurimeve shoqërore e shendetësore do të bëhet nga tatimpaguesi për këtë periudhë

LISTA E PUNONJËSVE PËRFITUES TË SUBJEKTIT (I VETËPUNËSUARI, PUNONJËSIT E PAPAGUAR TË FAMILJES DHE TË FAMILJES)

- Nëse zgjidhni **“Jam Dakord”**, ju do të vijoni të dorëzoni listë pagesën për secilin muaj, në formën që aktualisht e dorëzoni atë. Afati i deklarimit dhe pagesës së kontributeve shoqërore dhe TAP nuk ndryshojnë.
- Nëse zgjidhni **“Nuk jam dakord”**, ju do të keni mundësi të deklaroni listë pagesën **“Pa aktivitet”** për periudhat në vijim, **pa i larguar punonjësit me Formular E-sig/027**. Afati i deklarimit të listëpagesës nuk ndryshon.



Deklarimi dhe pagesa e sigurimeve shoqërore e shendetësore do të bëhet nga tatimpaguesi për këtë periudhë

Jam dakort
Nuk jam dakort

LISTA E PUNONJËSVE PËRFITUES TË SUBJEKTIIT (I VETËPUNËSUARI, PUNONJËSIT E PAPAGUAR TË FAMILJES DHE TË PUNËSI

Kujdes:

- Formulari nuk mund të dorëzohet nëse nuk është plotësuar secila prej kutizave të detyrueshme të përmendura më lart.
- Formulari nuk mund të ruhet për rishikim, pra plotësimi i tij duhet të kryhet për të gjithë punonjësit dhe më pas të dorëzohet